



**UNIVERSITETI I SHKODRËS
LUIGJ GURAKUQI**



**AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË**

Memorandum

i nënshkruar ndërmjet

**Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH)
dhe Universitetit të Shkodrës *Luigj Gurakuqi* (USH)**

Neni 1

Përcaktimi i *Palëve*

***Palët* në këtë Memorandum janë:**

- 1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), me qendër në Tiranë, sheshi *Fan Noli*, e përfaqësuar nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar;**
- 2. Universiteti i Shkodrës *Luigj Gurakuqi* (USH), me qendër në Shkodër, sheshi *2 Prilli*, 4001, i përfaqësuar nga prof. dr. Suzana Golemi, Rektor.**

Neni 2

Qëllimi

Ky Memorandum ka vlerën e një marrëveshjeje kuadër dhe nënshkruhet me qëllim që Palët të garantojnë zbatimin e prioriteteve themelore të bashkëpunimit, mbështetur në legjislacionin në fuqi, në parime të gjithëpranuara dhe në interesa të përbashkëta.

Neni 3

Raportet mes Palëve

Parim themelor rregullues për bashkëpunimin e Palëve është *autonomia akademike dhe universitare*. Ato bashkëpunojnë duke respektuar njëra-tjetrën në vetëveprimin e tyre të rregulluar me ligje dhe me akte nënligjore, duke ruajtur dhe zhvilluar traditat më të suksesshme, përmes nismash, projektesh dhe veprimtarish të përbashkëta akademike e universitare.

Neni 4

Parime etike

Në veprimtaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre Palët pranojnë zbatimin e *Kodit europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*. Ato mbajnë qendrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj të gjitha formave të plagjiaturës dhe pseudoshkencës.

Neni 5

Përparësi në bashkëpunim

Fushë përparësore bashkëpunimi për Palët janë kërkimet dhe studimet në *shkencat albanologjike*: gjuhësi, arkeologjia, historia, antropologjia kulturore, trashëgimia shpirtërore dhe identiteti.

Nanoshkenca e nanoteknologjia, bioshkenca e bioteknologjia, inteligjenca artificiale dhe shkencat e jetës; disiplinat e reja në shkencat natyrore dhe teknike, janë gjithashtu fusha përparësore të bashkëpunimit të Palëve.

Palët inkurajojnë ngritjen dhe zhvillimin e programeve të studimit me karakter ndërdisiplinor.

Neni 6

Detyrime specifike të ndërsjellëta

ASHSH garanton përfshirjen e ekspertëve të USH në njësitë e reja të kërkimit shkencor ngritur pranë saj. USH rekomandon e propozon përfshirjen e ekspertëve më cilësorë në këtë proces bashkëpunimi.

Përfaqësues të trupës akademike të USH marrin pjesë sipas fushave në komisionet e përhershme që funksionojnë pranë ASHSH.

Në respekt të legjislacionit në fuqi dhe të traditave të mirënjohura të bashkëpunimit, njësitë bazë të studimit dhe senatet akademike të USH marrin pjesë në procesin e promovimit të kandidatëve për anëtarë të Asamblesë së ASHSH, duke diskutuar e vlerësuar me shkrim profilin intelektual dhe ndihmesat shkencore të tyre.

ASHSH fton përfaqësues të USH të marrin pjesë si anëtarë jurie, vlerësues të jashtëm, recensues dhe oponentë në organizimin dhe zhvillimin e konkurseve shkencore për çmimet kombëtare vjetore të shpallura prej saj, në të gjitha fazat e tyre.

Përfaqësues të USH marrin pjesë në organizma të ASHSH ose që funksionojnë pranë saj, si Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, komiteti kombëtar i AIESEE-së, komiteti vendor i ALE (Atlas Linguarum Europae), këshilli i botimeve akademike etj.

USH mban në vlerësim vullnetin e shprehur nga ASHSH, që në senatet akademike të ketë anëtarë të Asamblesë së saj, pjesë e profesoratit.

Neni 7

Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

Palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjelltë dhe të pakushtëzuar të informacionit shkencor, të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe monografive. ASHSH u dhuron periodikisht koleksione të botimeve të saj bibliotekave të USH.

Palët shkëmbejnë ekspertiza dhe mbikëqyrje të përbashkëta të veprimtarisë shkencore në ekspedita dhe në kërkime.

Palët informojnë rregullisht njëra-tjetrën për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe me interes të ndërsjelltë.

Neni 8

Projekte kombëtare e ndërkombëtare

Palët nxisin përfshirjen reciproke të përfaqësuesve të tyre në aplikimin, konkurrimin dhe zbatimin e projekteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 9

Kohëzgjatja

Ky Memorandum ka fuqi veprimi pa kohë të caktuar. Ndërprerja e tij pranohet prej Palëve në rastet kur:

- Ndryshon statusi ligjor i institucioneve dhe ky ndryshim prek funksionet themelore të tyre, me efekt në Palën tjetër;*
- Njëra nga Palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cenimin e interesave bazë të saj në procesin e plotësimit të kushteve të këtij Memorandumi.*

Neni 10

Protokollet e bashkëpunimit

Me vullnetin e Palëve këtij Memorandumi i bashkëlidhen protokolle bashkëpunimi me afate që përcaktohen me diskutim mes tyre. Në plotësim të këtij Memorandumi protokolle mund të nënshkruhen edhe për një veprimtari shkencore të vetme.

Neni 11
Ankesat

Ky Memorandum është çështje dypalëshe. Për paqartësitë dhe ankesat e mundshme Palët nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër. Mosmarrëveshjet midis Palëve zgjidhen me bisedime.

Në rast të mosarritjes së dakordësisë për një periudhë dyvjeçare për çështje të diskutueshme, ky Memorandum e humbet fuqinë.

Neni 12
Të fundme

Ky Memorandum nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën Palë, me vlerë të barabartë.

Nënshkruar në Shkodër, më 03.04.2023

Për:

Universitetin e Shkodrës
Luigj Gurakuqi

Prof. dr. Suzana Golemi, Rektor



Nr. 1140 Prot

Akademinë e Shkencave
të Shqipërisë

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar

